

NJOFTIM PËR SHITJE PËRMES ANKANDIT TË PARË PUBLIK

Përmbauesi Privat **Isa Shala**, më datë 17.08.2021 ka sjellë Konkluzion mbi shitjen e paluajtshmërisë për lëndën **P.nr.177/2021**, e hipotekuar në favor të bankës BKT. Ngastra kadastrale me numër **P-71914059-04347-2**, me sipërfaqe prej 374 m², Zona Kadastrale Prishtinë, e evidentuar në emër të pronarit Bajram Bajrami, e bllokuar/hipotekuar në favor të kreditorit Banka Kombëtare Tregtare Kosovë SH.A.

Kjo pasuri e përshkruar më lartë do të shitet përmes Ankandit të Parë Publik, në mbështetje të plotë të dispozitës së Nenit 227 të LPP-së, me qëllim të sigurimit të mjeteve për të përmbushur detyrimet që debitori Suat Bajrami ka ndaj kreditorit – **Banka Kombëtare Tregtare Kosovë SH.A.**

» Vlera e paluajtshmërisë është vlerësuar në shumën prej: **150,000.00 €** (njëqind e pesëdhjetë mijë) Euro, pasuri e cila në ankand të parë të shitjes publike mund të shitet nën vlerën e përcaktuar, por jo nën 50% të vlerës së përcaktuar.

- Data e Ankandit të Parë Publik: **27.09.2021**
- Koha e shitjes – ora: **10:00**
- Vendi i shitjes: **Përmbauesi Privat Isa Shala, Adresa: Bulevardi Bill Clinton Hyrja 270 Nr.2, Prishtinë.**

Të gjithë të interesuarit duhet të deponojnë tek Përmbauesi Privat shumën prej 10 % të vlerës së cekur të paluajtshmërisë por jo më shumë se 5,000 Euro në emër të kaucionit, para se të fillojë shitja, por jo më vonë se data 26.09.2021, me të drejtë të kthimit të kaucionit pas përfundimit të ankandit, ofertuesve të pasuksesshëm.

Për informata me të hollësishme, ju lutem, kontaktoni në tel: 038 666 666; 045/700-790;

Prishtinë, 2021



038 666 666 | www.bkt-ks.com

Ne jemi gjithmonë këtu!